



KOMISIONI EVROPIAN

Bruksel, më 30.9.2013

C(2013) 6178, përfundimtar

**VENDIM ZBATUES I KOMISIONIT, DATË 30.9.2013, "PËR NDRYSHIMIN E
VENDIMIT TË KOMISIONIT C(2002) 3069 "PËR PËRCAKTIMIN E
SPECIFIKIMEVE TEKNIKE LIDHUR ME FORMATIN E UNIFIKUAR TË LEJEVE
TË QËNDRIMIT PËR SHTETASIT E VENDEVE TË TRETA"**

**(VETËM TEKSTET NË BULLGARISHT, KROATISHT, ÇEKISHT, HOLANDISHT,
ESTONISHT, ANGLISHT, FINLANDISHT, FRËNGJISHT, GJERMANISHT,
GREQISHT, HUNGARISHT, ITALISHT, SUEDISHT, LETONISHT, LITUANISHT,
MALTISHT, POLONISHT, PORTUGALISHT, RUMANISHT, SLLOVAKISHT,
SLLOVENISHT DHE SPANJISHT JANË ORIGJINALE)**

KOMISIONI EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1030/2002, datë 13 qershor 2002, "Për përcaktimin e një formati të unifikuar të lejeve të qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta"¹, dhe në veçanti nenin 2, paragrafi 1, germa "d" dhe "e" të saj,

Meqë:

1. Rregullorja (KE) nr. 1030/2002 i jep Komisionit kompetencat për të miratuar specifikime të mëtejshme teknike për lejet e qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta, me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe falsifikimit.

2. Vendimi i Komisionit C(2002) 3069 përcaktoi specifikimet teknike për zbatimin dhe mbrojtjen e të dhënave biometrike në lejet e qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta. Ai vendim u ndryshua nga Vendimet përfundimtare të Komisionit C(2009) 3770 dhe C(2011) 5478.

3. Vendimi C(2009) 3770 përcaktoi politikën e përbashkët të certifikimit për infrastrukturën e kontrollit të aksesit të gjerë për lejet e qëndrimit të lëshuara nga shtetet anëtare. Për shkak të parashikimit të një pike të vetme kontakti (SPOC) me Vendimin përfundimtar të Komisionit C (2011) 5478, nevojitet përditësimi i politikës ekzistuese të certifikimit për të marrë në konsideratë këtë situatë të re. Vendimi përfundimtar C(2011) 5478 prezantoi një nivel më të lartë mbrojtjeje për të dhënat biometrike, duke vendosur detyrimin e zbatimit të "Supplemental Access Control for Machine Readable Travel Documents (Kontrolli shtesë i aksesit për

dokumentet e udhëtimit të lexueshme nga pajisjet)". Për shkak të zhvillimit të standardeve të reja në këtë fushë, profilet e mbrojtjes dhe referimet në këto standarde në lidhje me "Kontrollin shtesë të aksesit (SAC)" duhet të ndryshohen.

4. Po ashtu, për arsye të zbatimit të saktë të vendimeve të Komisionit, është e nevojshme të përcaktohen specifikimet e testimit, për të garantuar ndërveprim ndërmjet shteteve anëtare.

5. Ndonëse standardi i ri përshkruan "lidhjen dinamike", me një nivel më të lartë sigurie, si rregull i përgjithshëm shtetet anëtare duhet të lejohen që gjatë lëshimit të pasaportave dhe dokumenteve të udhëtimit deri më 31 dhjetor 2014 të përdorin "lidhjen statike", duke marrë informacion nga pjesa e pasaportës që është e lexueshme nga pajisjet, në përputhje me specifikimet.

6. Duke qenë se Rregullorja (KE) 1030/2002 mbështetet në tërësinë e legjislacionit të Shengenit, në përputhje me nenin 5 të Protokollit për Qëndrimin e Danimarkës që i bashkëlidhet Traktatit për Bashkimin Evropian dhe Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, Danimarka njoftoi me anë të shkresës së datës 16 tetor 2008 transpozimin etërësisë së këtij legjislacioni në legjislacionin e saj kombëtar. Për rrjedhojë, ajo ka detyrimin të zbatojë këtë vendim në zbatim të legjislacionit ndërkombëtar.

7. Për sa i përket Islandës dhe Norvegjisë, ky vendim përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit sipas kuptimit të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë për asociimin e këtyre të fundit në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit², të cilat përfshihen në fushën e përmendur në nenin 1, pika C të Vendimit të Këshillit 1999/437/KE, datë 17 maj 1999, "Për disa rregulla lidhur me zbatimin e marrëveshjes".³

8. Në përputhje me nenin 3 të Protokollit për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe të Irlandës, bashkëlidhur Traktatit për Bashkimin Evropian dhe Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, Mbretëria e Bashkuar ka njoftuar, me shkresën e 29 dhjetor 2003, dëshirën e saj për të marrë pjesë në miratimin dhe zbatimin e Rregullores (KE) nr. 1030/2002.

9. Në përputhje me nenin 3 të Protokollit për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës, bashkëlidhur Traktatit për Bashkimin Evropian dhe Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, Irlanda ka njoftuar, me shkresën e datës 19 dhjetor 2003 dëshirën e saj për të marrë pjesë në miratimin dhe zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1030/2002.

10. Për sa i përket Zvicrës, ky vendim përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit sipas kuptimit të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës së Zvicrës për asociimin e kësaj të fundit në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit⁴ të Shengenit, të cilat përfshihen në fushën e përmendur në nenin 1, germa "B" të Vendimit të Këshillit 1999/437/KE, që lexohet i lidhur me nenin 3 të Vendimit të Këshillit 2008/146/KE⁵.

11. Për sa i përket Lihtenshtajnit, kjo rregullore përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit sipas kuptimit të Protokollit të nënshkruar ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian, Konfederatës së Zvicrës dhe Principatës së

Lihtenshtajnit për aderimin e kësaj të fundit në marrëveshjen ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës së Zvicrës për asociimin e Konfederatës së Zvicrës në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit, të cilat përfshihen në fushën e përmendur në nenin 1 pika B të Vendimit 1999/437/KE që lexohet i lidhur me nenin 3 të Vendimit të Këshillit 2011/350/BE⁶.

12. Masat e parashikuara në këtë vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të ngritur sipas nenit 6 të Rregullores (KE) nr. 1683/95.

13. Për rrjedhojë, Vendimi C (2002) 3069 duhet të ndryshohet në përputhje me sa më lart.

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

1. Shtohet neni 1a: "Neni 1a

Politika e përbashkët e certifikimit krijohet siç përcaktohet në BSI TR-03139, versioni 2.1. [<https://www.bsi.bund.de>]."

2. Shtojca IIa e Vendimit të Komisionit (KE) nr. C (2002) 3069 ndryshohet si më poshtë:

a) Pika referencë 3 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"3. Advanced Security Mechanisms for Machine Readable Travel Documents, BSI TR-03110, Part 1 and 3, Version 2.10 of 20 March 2012";

b) Pika referencë nr. 10 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"10. Common Criteria Protection Profile for Machine Readable Travel Document with "ICAO Application", Extended Access Control with PACE, BSI-CC-PP-0056-V2-2012"

c) Shtohen pikat e reja referencë 15 dhe 16:

"15. Specifikimet e testimit përcaktohen në BSI TR-03105 Part 3.2 Version 1.3 [<https://www.bsi.bund.de>]

16. Common Criteria Protection Profile Machine Readable Travel Document with „ICAO Application”, Basic Access Control, BSI-CC-PP-0055, Version 1.10 [<https://www.bsi.bund.de>]"

3. Shtojca IIb fshihet.

Neni 2

Shtetet anëtare mund të përdorin "lidhjen statike" të përmendur në paragrafin 3.5 të dokumenteve të përmendura në pikën 3 për lëshimin e pasaportave dhe dokumenteve të udhëtimit deri më 31 dhjetor 2014.

Neni 3

Ky vendim i drejtohet Mbretërisë së Belgjikës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës Çeke, Republikës Federale të Gjermanisë, Republikës së Estonisë, Irlandës, Republikës Helenike, Mbretërisë së Spanjës, Republikës së Francës, Republikës së Italisë, Republikës së Qipros, Republikës së Letonisë, Republikës së Lituanisë, Dukatës së Madhe të Luksemburgut, Hungarisë, Republikës së Maltës, Mbretërisë së Holandës, Republikës së Austrisë, Republikës së Polonisë, Republikës së Portugalisë, Rumanisë, Republikës së Sllovenisë, Republikës së Sllovakisë, Republikës së Finlandës dhe Mbretërisë së Suedisë, dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.

Nënshkruar në Bruksel, më 30.9.2013

Për Komisionin

Cecilia MALMSTRÖM

Anëtare e Komisionit

-
1. *Gazeta Zyrtare L 157, 15.6.2002, f. 1.*
 2. *Gazeta Zyrtare L 176, 10.7.1999, f. 36.*
 3. *Gazeta Zyrtare L 176, 10.7.1999, f. 31.*
 4. *Gazeta Zyrtare L 53, 27.2.2008, f. 52.*
 5. *Gazeta Zyrtare L 53, 27.2.2008, f. 1.*
 6. *Gazeta Zyrtare L 160, 18.6.2011, f. 19.*
-